

20141324177

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SHËRBBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

Neni 1

Në Ligjin për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 184/13,13/14, 44/14 dhe 101/14), në nenin 23 pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2), si vijon:

"(2) Me përjashtim të dispozitës nga paragrafi (1) alineja 2 e këtij neni, për mosrespektimin të dispozitave nga nenet 91 dhe 92 paragrafët (8) dhe (9) të këtij ligji, drejtori i Agjencisë do të parashtrojë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse pa miratuar paraprakisht aktvendim për vërejtje."

Në paragrafin (2) i cili bëhet paragraf (3) pas fjalëve: "paragrafi (1)" shtohen fjalët: "dhe paragrafi (2)".

Neni 2

Neni 92 ndryshohet si vijon:

"(1) Radiodifuzerët janë të obliguar që në ditë të emetojnë së paku 30% program burimor të krijuar në Republikën e Maqedonisë në gjuhën maqedonase ose në gjuhët e bashkësive joshumicë të cilat jetojnë në Republikën e Maqedonisë duke filluar nga viti 2014. Prej vitit 2015, obligimi prej 30% rritet në 40%. Prej vitit 2016, obligimi prej 40% rritet në 50%.

(2) Si shmangie nga paragrafi (1) i këtij neni, servisi publik radiodifuziv obligohet që në ditë të emetojnë së paku 40% program burimor të krijuar në Republikën e Maqedonisë në gjuhën maqedonase ose në gjuhët e bashkësive joshumicë të cilat jetojnë në Republikën e Maqedonisë. Në vitin 2015 obligimi është 50%. Prej vitit 2016, obligimi prej 50% rritet në 60%. Sigurimi i servisit programor të Kanalit të Kuvendit përjashtohet nga këto obligime.

(3) Dispozitat nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, nuk kanë të bëjnë me serviset programore të formatit të specializuar.

(4) Shoqëritë tregtare radiodifuzive që emetojnë servis programor televiziv të formatit të përgjithshëm janë të obliguara që gjatë javës të emetojnë së paku tetë orë, e servisi publik radiodifuziv së paku 14 orë, muzikë instrumentale nga autorë maqedonas dhe autorë të bashkësive etnike që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë, muzikë vokale dhe/ose vokale instrumentale, në gjuhën maqedonase ose në gjuhët e bashkësive joshumicë të cilat jetojnë në Republikën e Maqedonisë, prej të cilës 50% duhet të jetë muzikë argëtuese instrumentale, vokale dhe/ose vokale instrumentale, ndërsa 50% muzikë popullore instrumentale, vokale dhe/ose vokale instrumentale, me ç'rast lejohet shmangie prej 5% në lidhje me ndarjen e emetimit të muzikës argëtuese dhe popullore instrumentale, vokale dhe/ose vokale instrumentale.

(5) Servisi publik radiodifuziv detyrohet që së paku në një servis programor televiziv dhe një të radios në gjuhën maqedonase dhe në servisin programor televiziv dhe të radios në gjuhët e bashkësive etnike të cilat nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë, në ditë të sigurojë që së paku 50% nga muzika e emetuar, instrumentale, vokale dhe vokale-instrumentale burimore e krijuar në Republikën e Maqedonisë të jetë në gjuhën maqedonase ose në gjuhën e bashkësive etnike të cilat nuk janë shumicë.

(6) Radiodifuzerët janë të obliguar që së paku gjysmën e obligimit për muzikë të përcaktuar në paragrafët (4) dhe (5) të këtij neni ta realizojnë në periudhën prej orës 7,00 deri në orën 19,00.

(7) Rregullat për realizimin e obligimeve të këtij neni më hollësisht i përcakton Agjencia.

(8) Shoqëritë tregtare radiodifuzive që emetojnë servis programor televiziv të formatit të përgjithshëm në nivel shtetëror përmes kapacitetit transmetues të multipleksit terestrial digjital, obligohen që të prodhojnë dhe emetojnë së paku 10 orë program dokumentar vendor në

periudhën prej orës 7,00 deri në orën 23,00, më së voni deri më 25 nëntor në vitin rrjedhës, kurse servisi publik radiodifuziv së paku 30 orë program dokumentar vendor në periudhën prej orës 7,00 deri në orën 23,00, më së voni deri më 25 nëntor në vitin rrjedhës.

(9) Shoqëritë tregtare radiodifuzive që emetojnë servis programor televiziv të formatit të përgjithshëm në nivel shtetëror përmes kapacitetit transmetues të multipleksit terestrial digjital, obligohen që të prodhojnë dhe emetojnë së paku 20 orë program artistik vendor në periudhën prej orës 7,00 deri në orën 23,00, më së voni deri më 25 nëntor në vitin rrjedhës, kurse servisi publik radiodifuziv së paku 30 orë program artistik vendor në periudhën prej orës 7,00 deri në orën 23,00, më së voni deri më 25 nëntor në vitin rrjedhës.

(10) Shoqëritë tregtare radiodifuzive dhe servisi publik radiodifuziv për plotësimin e obligimit për prodhim të përcaktuar në paragrafët (8) dhe (9) të këtij neni, kanë të drejtë të kompensimit për mbulim të shpenzimeve në lartësi prej 50% që paguhet nga mjetet e buxhetit të Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës, të miratuar për atë dedikim e në bazë të vendimit nga neni 92-a i këtij ligji.

(11) Kompensimi nga paragrafi (10) i këtij neni, paguhet nëse programi dokumentar vendor dhe programi artistik vendor i përmban kriteret themelore në vijim:

- origjinalitet, autenticitet dhe kualitet të përmbajtjes së skenarit,
- qëndrueshmëri të produksionit të projektit televiziv të tipit të realizimit të projektit në lidhje me skenarin, buxhetin, ndërlikueshmërinë, planin dhe terminet për incizim dhe
- teknologji për produksion kur bëhet fjalë për program artistik vendor.

(12) Struktura e shpenzimeve që pranohen për mbulimin në pajtim me paragrafin (10) të këtij neni, si dhe kriteret e veçanta nga paragrafi (11) i këtij neni, më hollësisht përcaktohen me akt nënligjor që e miraton Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

(13) Programi dokumentar vendor nga paragrafi (8) i këtij neni dhe programi artistik vendor nga paragrafi (9) i këtij neni, konsiderohen se janë programe me interes publik për Republikën e Maqedonisë.

(14) Radiodifuzerët janë të obliguar që së paku gjysmën e përqindjes nga obligimet nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, ta realizojnë prej orës 7,00 deri në orën 19,00.

(15) Radiodifuzerët e radios janë të obliguar që në ditë, të sigurojnë së paku 40% nga muzika e emetuar instrumentale, vokale ose vokale-instrumentale, të jetë në gjuhën maqedonase ose në gjuhën e bashkësive etnike të cilat nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë. Kjo dispozitë nuk ka të bëjë me servisin publik radiodifuziv.”

Neni 3

Pas nenit 92 shtohen 11 nene të reja 92-a, 92-b, 92-v, 92-g, 92-d, 92-gj, 92-e, 92-zh, 92-z, 92-x dhe 92-i, si vijojnë:

"Neni 92-a

Shuma maksimale për pagim të kompensimit

Shuma maksimale për pagim të kompensimit nga neni 92 paragrafi (10) i këtij ligji, për prodhim të programit dokumentar vendor dhe të programit artistik vendor sipas llojeve (filma televizivë, filma të animuar, seri dhe seriale, monodrama dhe drama, komedi të situatave, telenovela dhe opera sapunike), përcaktohet me vendim që e miraton Qeveria e Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e miratimit të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë me propozim të Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

Neni 92-b

Komisioni ndërresorial

(1) Plotësimin e kriterëve nga neni 92 paragrafi (11) i këtij ligji, si dhe propozimin për pagimin e mjeteve për mbulimin e shpenzimeve për prodhim të programit dokumentar vendor dhe/ose programit artistik vendor, i përcakton komisioni ndërresorial (në tekstin e mëtejme: Komisioni) të cilin e formon Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

(2) Komisioni përbëhet nga shtatë anëtarë dhe zëvendësit e tyre edhe atë me nga një përfaqësues dhe zëvendës nga: Ministria e Financave, Ministria e Kulturës, Agjencia për Film, Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, përfaqësues nga zyra e Kryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Drejtoria e të Hyrave Publike dhe Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

(3) Mandati i anëtarëve dhe zëvendësve të tyre në Komision është dy vjet.

(4) Dispozitat nga neni 16 paragrafët (1) dhe (2) dhe neni 17 paragrafi (1) të këtij ligji në mënyrë përkatëse do të zbatohen edhe në aspekt të kushteve për zgjedhjen dhe ndërprerjen e mandatit të anëtarit dhe zëvendësit të tij.

(5) Anëtarët e Komisionit dhe zëvendësit e tyre gjatë zgjedhjes së tyre dorëzojnë deklaratë të verifikuar në noter se i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 16 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji.

(6) Komisioni nga radhët e anëtarëve të vet zgjedh kryetar dhe zëvendëskryetar i cili i konvokon dhe udhëheq mbledhjet e komisionit.

(7) Komisioni vendos me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

(8) Komisioni për punën e vet miraton Rregullore për punë.

Neni 92-v

Kompetenca e komisionit

(1) Fushëveprimi i punës së komisionit nga neni 92-b është që:

- ta miratojë propozim-projektin për prodhim të programit dokumentar vendor dhe/ose programit artistik vendor,
- ta ndjekë procesin e prodhimit të propozim-projektit të miratuar për prodhim të programit artistik vendor dhe/ose programit dokumentar vendor,
- t'i kontrollojë dhe përcaktojë shpenzimet e bëra reale për prodhim të projektit të miratuar për prodhim të programit artistik vendor dhe/ose programit dokumentar vendor,
- të dorëzojë propozim te Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës për pagimin e shpenzimeve për prodhim të programit dokumentar vendor dhe/ose programit artistik vendor.

(2) Komisioni për punën e vet te Qeveria e Republikës së Maqedonisë dorëzon raport vjetor për punë për vitin paraprak. Raporti vjetor dorëzohet më së voni deri në fund të janarit në vitin rrjedhës.

Neni 92-g

Thirrja publike

(1) Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, në afat prej 30 ditësh nga dita e miratimit të vendimit nga neni 92-a i këtij ligji, shpall thirrje publike për dorëzimin e kërkesës për miratim të projektit për prodhim të programit dokumentar vendor dhe programit artistik vendor, për të cilin do të kryhet pagim i kompensimit për mbulimin e shpenzimeve, që zgjat 15 ditë.

(2) Shoqëritë tregtare radiodifuzive të cilat emetojnë servis programor televiziv të formatit të përgjithshëm në nivel shtetëror përmes kapacitetit transmetues të multipleksit terestrial digjital dhe servisi publik radiodifuziv në afatin e përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni, te Komisioni

nga neni 92-b i këtij ligji, me kërkesën nga paragrafi (1) i këtij neni, dorëzojnë propozim-projekt për prodhim të programit dokumentar vendor dhe/ose programit artistik vendor, për vitin rrjedhës.

(3) Propozim-projekti nga paragrafi (2) i këtij neni, veçanërisht përmban:

- Përshkrim dhe lloj të programit dokumentar vendor dhe/ose programit artistik vendor,
- Afat dhe dinamikë për prodhimin e tij (fillim dhe fund të prodhimit), me caktimin e lokacioneve,
- Resurse të parapara për prodhim të programit dokumentar vendor dhe/ose programit artistik vendor,
- Konstruksion financiar të projektit dhe
- Person për kontakt (adresë, telefon, telefaks, e-mail).

Neni 92-d

Miratimi i propozim-projektit

(1) Komisioni nga neni 92-b i këtij ligji, pas propozim-projekteve të marra nga neni 92-g paragrafi (2) i këtij ligji, më së voni në afat prej 15 ditësh nga dita e mbarimit të thirrjes publike nga neni 92-g paragrafi (1) i këtij ligji, vendos për plotësimin e kriterëve themelore nga neni 92 paragrafi (11) i këtij ligji.

(2) Komisioni propozim-projektet e miratuara, më së voni në afat prej tri ditësh nga dita e miratimit të tyre, i dorëzon te Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Neni 92-gj

Ndjekja e procesit të prodhimit

(1) Shoqëritë tregtare radiodifuzive të cilat emetojnë servis programor televiziv të formatit të përgjithshëm në nivel shtetëror përmes kapacitetit transmetues të multipleksit terestrial digjital dhe servisi publik radiodifuziv të cilëve u janë miratuar propozim-projektet në bazë të nenit 92-d të këtij ligji, te Komisioni nga neni 92-b i këtij ligji, dorëzojnë raport tekstual dhe foto raport për rrjedhën dhe fazat e prodhimit të programit dokumentar vendor dhe/ose programit artistik vendor, në të cilin qartë do të shihen pjesëmarrësit në projekt, tipi i pajisjes teknologjike të përdorur për incizim nëse bëhet fjalë për program artistik vendor dhe autenticiteti i lokacionit ose studios.

(2) Shoqëritë tregtare radiodifuzive të cilat emetojnë servis programor televiziv të formatit të përgjithshëm në nivel shtetëror përmes kapacitetit transmetues të multipleksit terestrial digjital dhe servisi radiodifuziv publik detyrohen që t'i mundësojnë këqyrje të lirë dhe ndjekje gjatë tërë procesit të prodhimit, kur këtë do ta kërkojë Komisioni.

(3) Ndjekjen në procesin e prodhimit me këqyrje të drejtpërdrejtë Komisioni mund ta kryejë në çdo kohë, në pajtim me afatin e propozuar dhe dinamikën për prodhim nga neni 92-g paragrafi 3 i këtij ligji, për çka përpilon procesverbal.

Neni 92-e

Obligimi për njoftim të Agjencisë

Shoqëritë tregtare radiodifuzive të cilat emetojnë servis programor televiziv të formatit të përgjithshëm në nivel shtetëror përmes kapacitetit transmetues të multipleksit terestrial digjital dhe servisi publik radiodifuziv detyrohen që pesë ditë para fillimit me emetim të projektit të miratuar nga neni 92-d paragrafi (1) i këtij ligji, në formë të shkruar ose elektronike ta njoftojnë Agjencinë për periudhën e emetimit të të njëjtit.

Neni 92-zh

Kërkesa për pagim të kompensimit

(1) Shoqëritë tregtare radiodifuzive të cilat emetojnë servis programor televiziv të formatit të përgjithshëm në nivel shtetëror përmes kapacitetit transmetues të multipleksit terestrial digjital dhe servisi publik radiodifuziv, pas realizimit të prodhimit dhe emetimit të propozim-projektit të miratuar nga neni 92-d paragrafi (1) i këtij ligji, më së voni deri më 30 nëntor në vitin rrjedhës në Komisionin nga neni 92-b i këtij ligji, të parashtrojnë kërkesë për pagim të kompensimit për mbulim të shpenzimeve për prodhim të projektit të miratuar nga neni 92-d i këtij ligji.

(2) Me kërkesën nga paragrafi (1) i këtij neni, parashtrohet edhe listë e shpenzimeve të grupuara sipas strukturës, me dëshmi të bashkëngjitura.

Neni 92-z

Kërkesa për të dhëna dhe përcaktim të shpenzimeve

(1) Komisioni nga neni 92-b i këtij ligji në afat prej dy ditëve nga dita e pranimi të kërkesës nga neni 92-zh i këtij ligji, në Agjenci parashtron kërkesë për marrje të të dhënave me të cilat vërtetohet emetimi i realizuar i projektit të miratuar nga neni 92-d i këtij ligji.

(2) Agjencia detyrohet në afat prej dy ditëve nga dita e pranimi të kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni Komisionit t'ia dorëzojë të dhënat e kërkuara.

(3) Komisioni në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimi të të dhënave nga paragrafi (2) i këtij neni, i përcakton shpenzimet e bëra reale për prodhim të projektit të miratuar nga neni 92-d i këtij ligji në pajtim me aktin nënligjor nga neni 92 paragrafi (12) i këtij ligji.

(4) Komisioni në afat prej dy ditëve nga dita e përcaktimit të shpenzimeve nga paragrafi (3) i këtij neni, parashtron propozim në Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratës për pagim të shpenzimeve për prodhim të programit dokumentar vendor dhe/ose programit artistik vendor.

Neni 92-x

Ndarja e kompensimit të paguar

(1) Shoqëritë tregtare radiodifuzive të cilat emetojnë servis programor televiziv të formatit të përgjithshëm në nivel shtetëror përmes kapacitetit transmetues të multipleksit terestrial digjital dhe servisi publik radiodifuziv, kompensimin e paguar nga neni 92-z i këtij ligji në pjesën e honorarëve autoriale dhe honorarëve tjera, e ndajnë në mënyrën në vijim:

- deri 8% të mjeteve të marra nga kompensimi i paguhen regjisorit nëse ka diplomuar në regji dhe ka incizuar së paku një seri ose film artistik, ndërsa nëse regjisori është fillestar i paguhen deri 5%,

- deri 8% të mjeteve të marra nga kompensimi i paguhen producentit nëse ka diplomuar në produksion, kurse nëse producenti është fillestar i paguhen deri 5%,

- deri 5% të mjeteve të marra nga kompensimi i paguhen skenaristit nëse ka diplomuar në skenar, kurse nëse skenaristi është fillestar i paguhen deri 3%,

- deri 3,5% të mjeteve të marra nga kompensimi u paguhen drejtorit të fotografisë, skenografit, kostumografit, montazhistit, autorit të muzikës, dizajnit të audios dhe bartësit të rolit kryesor me më së shumti deri dy role kryesore,

- deri 2,5% të mjeteve të marra nga kompensimi u paguhen bartësve të roleve tjera, përkatësisht autorëve tjerë të cilët kontribuojnë në film dhe

- deri 2% të mjeteve të marra nga kompensimi u paguhen anëtarëve tjerë teknikë ose anëtarëve tjerë të përmendur autorialë të ekipit filmik.

(2) Shoqëritë tregtare radiodifuzive të cilat emetojnë servis programor televiziv të formatit të përgjithshëm në nivel shtetëror përmes kapacitetit transmetues të multipleksit terestrial digjital dhe servisi publik radiodifuziv në Komision parashtrojnë raport për kompensimin e paguar nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Komisioni mund të kryejë këqyrje në ndarjen nga paragrafi (1) i këtij neni me qëllim që ta hetojë autenticitetin e të dhënave nga raporti i paragrafit (2) të këtij neni.

(4) Nëse Komisioni gjatë këqyrjes së realizuar nga paragrafi (3) i këtij neni konstaton se kompensimi nuk është ndarë në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni, atëherë shoqëria tregtare radiodifuzive e cila emeton servis programor televiziv të formatit të përgjithshëm në nivel shtetëror përmes kapacitetit transmetues të multipleksit terestrial digjital ose servisi publik radiodifuziv detyrohet ta kthejë kompensimin e paguar në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të aktit me të cilin është përcaktuar kthim i kompensimit të paguar.

Neni 92-i

Obligimi për parashtrim të kopjes digjitale

Pas pagimit të kompensimit nga neni 92-z i këtij ligji, shoqëria tregtare radiodifuzive e cila emeton servis programor televiziv të formatit të përgjithshëm në nivel shtetëror përmes kapacitetit transmetues të multipleksit terestrial digjital dhe servisi publik radiodifuziv detyrohen në afat prej 15 ditëve nga dita e pagimit të kompensimit në Kinotekën e Republikës së Maqedonisë të parashtrojnë një kopje digjitale të projektit të miratuar nga neni 92-d i këtij ligji në rezolucion maksimal në të cilin i njëjti është incizuar."

Neni 4

Në nenin 136 pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3) si vijon:

"(3) Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të Agjencisë do të përcaktojë se cilët detyrës në vendbanimet, të cilët janë liruar nga pagimi i taksës radiodifuzive në bazë të paragrafit (2) të këtij neni, do të paguajnë taksë radiodifuzive për shkak të mbulimit të sigurtuar me sinjale radiodifuzive të NP Radiodifuzioni Maqedonas nëpërmjet të cilit emitoen serviset programore të RTM-së."

Paragrafët (3) dhe (4) bëhen paragrafë (4) dhe (5).

Neni 5

Në nenin 149 paragrafi (1) pas pikës 7) shtohet pikë e re 8) si vijon:

"8) nuk parashtron një kopje digjitale të projektit të miratuar në rezolucion maksimal në të cilin i njëjti është incizuar në Kinotekën e Republikës së Maqedonisë (neni 92-i);"

Pikat 8), 9), 10), 11), 12), 13), 14) dhe 15) bëhen pika 9), 10), 11), 12), 13), 14), 15) dhe 16).

Neni 6

Në nenin 154 në paragrafin (2) numri "30" zëvendësohet me numrin "90".

Neni 7

(1) Për vitin 2014 pagimi i mjeteve në pajtim me nenin 92 paragrafi (10), bëhet deri në fund të dhjetorit 2014 me kusht që shoqëritë tregtare radiodifuzive të cilat emetojnë servis programor televiziv të formatit të përgjithshëm në nivel shtetëror përmes kapacitetit transmetues të multipleksit terestrial digjital dhe servisi publik radiodifuziv të kenë mbaruar me prodhimin e programit dokumentar vendor dhe/ose programit artistik vendor, në Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratës të kenë parashtruar nga një kopje digjitale nga të gjitha programet e incizuara në rezolucion maksimal në të cilin janë incizuar, si dhe të kenë filluar me emetimin e tyre deri në fund të dhjetorit 2014, që duhet të mbarojë deri më 31 janar 2015.

(2) Nëse emetimi i plotë i programeve nuk përfundon deri më 31 janar 2015, mjetet e paguara tërësisht kthehen në Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratës më së voni deri më 15 shkurt 2015 kurse obligimet e përcaktuara në nenin 92 paragrafët (8) dhe (9) konsiderohen si të papërbushura.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".